

ROLI I REVISTËS “DRITA” NË ZGJIMIN E VETËDIJES KOMBËTARE

Sokol MEMETI¹

¹Histori, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Tetovës

^{2*}Corresponding author e-mail: sokol.memeti@unite.edu.mk

Abstrakt

Shtypi shqiptar gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare zhvillohej në kushte të vështira, kjo për shkak të rrethanave në të cilat gjendeshin shqiptarët nën sundimin osman, por edhe për shkak të mungesës së të ardhurave financiare nga ana e botuesve. Mirëpo edhe përkundër kushteve të këqija, shtypi shqiptar pati zhvillim deri në një farë mase. Filluan të botohen gazeta e revista në gjuhën shqipe ndër të cilat e kemi edhe revistën “Drita” të Shahin Kolonjës, e botuar në Sofje të Bullgarisë, roli dhe kontributi i së cilës është trajtuar në këtë punim.

Qëllimi i punimit është që përpos se të analizohet roli dhe kontributi i revistës “Drita” në ngritjen e vetëdijes kombëtare të shqiptarët, të analizohet edhe kontributi i saj në lëvrimin e gjuhës shqipe, në çështjen e alfabetit dhe ngjarjeve kulturore në atë kohë. Është analizuar edhe roli i kësaj reviste në popullarizimin e luftës së shqiptarëve për çlirim nga Perandoria Osmane dhe kontributin e veçantë në përkrahjen e lëvizjeve të kohës si dhe kryengritjeve të ndryshme që zhvilloheshin në trojet shqiptare. Po ashtu është folur për rolin që mori kjo revistë si zëri i atyre shqiptarëve, të cilët nuk shihnin rrugë tjetër përveç çlirimit.

Rëndësi i është dhënë edhe kolumnave ku u kundërshtuan ashpër aspiratat e vendeve fqinje për aneksimin e trojeve shqiptare si dhe për diskutimet e ashpra që pati kjo revistë me gazeta dhe botues të ndryshëm të vendeve ballkanike.

Fjalët kyçe: revista “Drita”, Perandoria Osmane, shtetet ballkanike, çlirimi, kultura.

Abstract

The Albanian press during the period of the Albanian National Renaissance developed in difficult conditions, due to the circumstances in which the Albanians found themselves under the Ottoman rule, but also due to the lack of financial income from the publishers.

But despite the bad conditions, the Albanian press developed to a certain extent. Newspapers and magazines began to be published in the Albanian language, among which we have the magazine “Drita” by Shahin Kolonja, published in Sofia, Bulgaria, whose role and contribution is discussed in this paper.

The purpose of the paper is to analyze the role and contribution of the “Drita” magazine in raising the national consciousness among Albanians, to analyze its contribution to the development of the Albanian language, the alphabet and cultural events at that time. The role of this magazine in the popularization of the struggle of Albanians for liberation from the Ottoman Empire and the special contribution in supporting the movements of the time as well as the various uprisings that took place in the Albanian territories have also been analyzed. It has also been talked about the role that this magazine took as the voice of those Albanians who saw no other way but liberation.

Importance has also been given to the columns where the aspirations of the neighboring countries for the annexation of Albanian territories were strongly opposed, as well as to the harsh discussions that this magazine had with various newspapers and publishers of the Balkan countries.

Key words: “Drita” magazine, Ottoman Empire, Balkan states, liberation, culture.

Hyrje

“*Drita*” padyshim është revista me frymën më revolucionare ndër të gjitha të tillat të periudhës së Rilindjes Kombëtare. Paralel me kontributin për kulturë dhe gjuhë të “*Albanias*” së Konicës ajo do t’i bëjë jehonë luftës së armatosur dhe politike të shqiptarëve përpos kësaj ajo u bë organ përfaqësues i Komitetit “*Për lirinë e Shqipërisë*”. Vija e kësaj reviste me të vërtetë ishte e palëkundur deri në fund të botimit të saj edhe përkundër ndihmave financiare austro-hungareze, një qëndrim që e bëri atë ndër më të admiruarën për lexuesit e kohës. Shumë lehtë mund të thuhet se “*Drita*” ndoqi vijën politike të rrymës radikale të rilindësve, që e shihnin të ardhmen e shqiptarëve të pavarur nga Perandoria Osmane dhe të cilën do ta arrinin me anë të luftës së armatosur. Karakteristikë e kësaj gazete ishte përhapja e gjerë që ajo arriti në trojet shqiptare.

“*Drita*” ishte revistë e përdyjavshme me drejtor Shahin Kolonjën. Ajo botohej në Sofje në shtypshkronjën “*Mbrothësia*”. Numri i parë i saj doli më 14 nëntor të vitit 1901 dhe vijoi me 101 numra deri në vitin 1908. Ajo shtypej në gjuhën shqipe me *Alfabetin e Stambollit*por do të botoheshin artikuj edhe në gjuhën greke, turke e frënge me format prej 4 faqesh. Moto e revistës ishte “*Punoni për vehten tuaj. Mos për botë e për të huaj*”. Në dy faqet e para botoheshin lajme dhe artikuj nga shqiptarët e Shqipërisë. Vjontërubrika me titull *Te-Ra*, në të cilën kishte artikuj për Perandorinë Osmane dhe Shqipërinë. Rubrika e fundit ishte “*Të ndryshme*” ku botoheshin vjersha, këngë e lajme të llojllojshme. Rubrika të përkohshme ishin edhe “*Andej-këtej*” dhe “*Zedhenja dhe reklama*”. “*Drita*” ishte e para revistë që u përpoq të botonte lajme dhe ndodhi nga Shqipëria. Për vetë frymën që promovonte do të kishte një tirazh të madh sa në vitin 1904 arriti deri në 670 kopje. Me të bashkëpunuan Fan Noli, Mihal Grameno, Luigj Gurakuqi, Asdreni, Jani Vruho, Aleksandër Xhuvani, Hilë Mosi, Petro Nini Luarasi etj.¹

I. Kontributi për kulturën, gjuhën dhe arsimin

I.1. Arsimi

Përveç se kishte karakter revolucionar dhe luftarak, revista e Shahin Kolonjës një mund të madh e dha edhe për çështjen e arsimit, gjuhës e kulturës shqiptare ku, sipas kësaj reviste dija dhe arsimit identifikoheshin me dritën. Revista çështjen e shkollimit të shqiptarëve e shihte me shumë rëndësi. Sipas një artikulli të redaksisë me titull “*Dituria me gjuhët të vet mban gjall një komp*” shqiptarët ishin trima dhe të zgjuar por kjo ishte e kotë përderisa ata nuk arsimoheshin dhe si të tillë quheshin të egër nga popujt fqinjë. Sipas Shahin Kolonjës, autor i artikullit, për të rrëzuar pretendimet e vendeve fqinje duhej të hapeshin shkolla dhe në këtë mënyrë populli ynë do të mund të qeveriste veten. Ai merrte shembull përparimin kulturor të popujve fqinjë dhe shprehej se edhe ne medoemos do ta arrinim një gjë të tillë. Ai në vazhdim akuzonte Perandorinë Osmane se ajo ishte pengesa më e madhe e emancipimit të shqiptarëve, pasi nuk u lejonte shkollim në gjuhën shqipe dhe se për shkak të saj kishte pllakosur padija dhe analfabetizmi te ta.²

¹Blendi Fevziu,*Historia e shtypit shqiptar 1848-2005*, Tiranë: Onufri, 2005, f. 31-32, 149; *Historia e Popullit Shqiptar II-Rilindja Kombëtare-vitet e 30 të shek. XIX-1912.*, Tiranë: Toena, 2002, f. 344; Ismet Dërmaku, *Rilindja Kombëtare Shqiptare dhe kolonitë shqiptare të mërgimit në Rumani dhe Bullgari*, Prishtinë: Progres-S. Gjorgjeviq, 1987, f. 261; Fehari Ramadani, *Kontributi i Austro-Hungarisë për zhvillimin e arsimit dhe të kulturës shqiptare 1900-1912*, Tetovë: Arbëria Design, 2010, f. 145.

²Zihni Haskaj, *Mendimi politik dhe shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare (Përmbledhje artikujsh nga shtypi)*, vëllimi I, Tiranë: Mihal Duri, 1971, f. 268-275.

Në adresë të **“Dritës”** mbërriti një artikull i titulluar *“Letra nga Shkodra”* ku flitej për represionet dhe shtypjet që kishin bërë institucionet osmane kundër shkollave, librave e shkrimit shqip në këtë qytet. Gjithnjë sipas Shahin Kolonjës, me anë të shkollave turke, greke e italiane, shqiptarët që kanë fe të ndryshme shumë shpejt do të shkriheshin si komb dhe kjo do të ishte një dështim i madh për rilindësit që punonin për çlirimin e atdheut. Akuza pati edhe ndaj bejlerëve, të cilët nuk jepnin aspak kontribut për hapjen e shkollave shqipe, pasi sipas gazetës, atyre iu interesonte që populli i thjeshtë të ngelej i pashkolluar.³

Një rëndësi të madhe **“Drita”** i kushtonte edhe arsimimit dhe emancipimit të grave. Sipas revistës në fjalë, ato gra të shkolluara do të rritnin fëmijë dhe kështu do t’i edukonin më mirë. Ky organ theksonte se nuk do të ishte mirë që të vazhdoheshin të ruhen traditat e vjetra të ngujimit dhe shtypjes së grave, sepse tani edhe forca e tyre na duhej si kurrë më parë. Me shumë entuziazëm **“Drita”** e priti edhe hapjen e shkollës së natës në Konstancë të Rumanisë, ku edhe botoi njoftimin e Asdrenit se kjo do të shërbente për hapjen e të tjerave në këtë shtet. Sakrificat e **“Dritës”** për shkollat shqipe shihet edhe në përmendjen e saj në Promemorien dërguar Ministrisë së Jashtme të Austro-Hungarisë ku kërkohet ndihma për libra dhe shkolla në gjuhën shqipe.⁴

I.2. Gjuha

Një ndihmë të madhe kjo revistë do të jep edhe për gjuhën shqipe dhe alfabetin e saj. **“Drita”** u bë promotor dhe mbrojtëse më e flaktë e *Alfabetit të Stambollit*. Vetë Shahin Kolonja, një adhurues i flaktë i vëllezërve Frashëri dhe i *“Shoqërisë së Stambollit”* e llogariste atë si alfabetin më të përsosur për gjuhën shqipe. Për këtë ai do bëjë mjaft polemika me personalitete të ndryshme, përfshi edhe Faik Konicën. Për të dhënë mundin e saj **“Drita”** do të hapte një rubrikë të posaçme për gjuhën shqipe dhe alfabetin e saj. Angazhimi serioz i saj do të shihej kur pas mosmarrëveshjeve mes shqiptarëve dhe duke dashur që ata të kishin një alfabet të përbashkët do të botonte iniciativën për një **Kongres kombëtar për alfabetin** ku edhe paraqiti programin e tij me 6 pika.⁵

Si faktor të rëndësishëm për çështjen shqiptare **“Drita”** e shihte edhe formimin e **gjuhës standarde shqipe** dhe drejtshkrimit të saj. Shahin Kolonja në një artikull të tij insistonte se, për armiq të tanë gjuha shqipe është halë në sy dhe mu për këtë, ne duhej ta lëvronim dhe ta përhapnim sa më shumë. Vetë drejtuesi i revistës, për këtë çështje botoi artikullin me titull *“Shkrim, këndim, abetare e gjuhës shqipe”*. Sipas këtij artikulli, tani gjuha shqipe ishte shumë e varfër dhe e pa lëvruar dhe në anën tjetër shumë artikullshkrues me botimet e tyre e kishin sjellë në gjendje edhe më të keqe. Sipas **“Dritës”** rregullat gramatikore dhe të drejtshkrimit duhej që të mbështeteshin në punën e Konstandin Kristoforidhit dhe Jani Vretos. Duke pranuar letra nga shumë vise shqiptare **“Drita”** do ta pasurojë gjuhën shqipe me shumë fjalë, me këtë edhe do të bënte përafrimin e dialekteve të saj. Në faqet e **“Dritës”** po ashtu u fol edhe për emrat, mbiemrat, gjininë, rasat dhe numrin si kategori gramatikore. Kështu në numrin 37 të saj u fol për emrat asnjans dhe numrin. Për rrënjën e emrit, rasat dhe gjinitë u fol në numrin vijues. Në numrat në vazhdim aty u fol edhe për emrat e përgjithshëm, përemrat, mbiemrat, për lakimin në rasi etj. Për sa i përket letërsisë aty u botuan poezitë e Thoma Avramit, Asdrenit dhe Josif Bagerit.⁶

³Ismet Dërmaku, *vep. cit.*, f. 272-275.

⁴Zihni Haskaj, *vep. cit.*, f. 291-293; Ismet Dërmaku., *vep. cit.*, f. 330-331; Fehari Ramadani, *vep. cit.*, f. 217.

⁵Ismet Dërmaku, *vep. cit.*, f. 270-272, 348-349.

⁶Po aty, f. 271-274.

II. Kontributi për çështjen kombëtare

II.1. Polemikak me shtetet fqinje

Siç edhe e kemi cekur, në pjesën më të madhe të botimeve të saj **“Drita”** u mor me çështje politike dhe u bë tribunë e shumë lëvizjeve dhe kryengritjeve që ndodhën në Shqipëri. Ajo gjithmonë do t’i dalë në mbrojtje çështjes shqiptare nga sulmet, shpifjet e përpjekjet për pushtim të vendeve fqinje apo të Fuqive të Mëdha.

Kjo revistë sulme të mëdha drejtoi sidomos kundër qarqeve shoviniste greke dhe shumë grekomanëve që e luftonin çështjen kombëtare shqiptare dhe dëshironin realizimin e *Megali Idesë*. Kjo vinte mbase se drejtori i saj, i lindur dhe rritur në zonën e Kolonjës ishte ballafaquar me sulmet e andartëve dhe propagandës greke. Si më aktivët kundër politikës greke tekjo revistë ishin Shahin Kolonja dhe Asdreni. **“Drita”** në faqet e saj do të flasë për andartët grekë, të cilët bënë masakra dhe dëme të mëdha ndaj shqiptarëve në jug të Shqipërisë. Ajo gjithashtu i akuzonte ata si vrasës edhe të Spiro Kosturit, Papa Kristo Negovanit dhe të vëllait të tij, ngjarje këto të dokumentuara në disa letra të dërguara nga atdhetarë prej Shqipërie. Sipas gazetës, andartët grekë këto krime ndaj tyre i kishin bërë vetëm për shkak se ata kishin kërkuar gjuhë dhe arsim shqip. Revista, sulme adresoi edhe kundër mitropolitit Foti dhe Dhimogjerondisë së Korçës, si vegla të qarqeve greke dhe si keqpërdorues të fesë së krishterë, të ritit ortodoks për qëllime shoviniste. Sipas revistës, Fotit më së shumti i pengonte shkollimi shqip i shqiptarëve dhe kështu ai përdorte fenë për ta ndaluar një gjë të tillë. **“Drita”** po ashtu, do të polemizonte me gazetën greke si *“Pirros”*, *“To Kratos”* dhe *“Elenizmos”* të cilat, shqiptarët ortodoksë i quanin grekë dhe territoret e Shqipërisë së Jugut si toka greke. Asdreni do të ishte mjaft aktiv në polemikat drejtuar këtyre organeve greke, duke përdorur mjaft fakte dhe një gjuhë të ashpër gazetareske. Polemika të ashpra do të zhvilloheshin edhe me disa personalitete shoviniste greke si Karolodhi, Kristovasili, Spiliotopule dhe Kazaziz, të cilët njashtu kërkonin bashkimin e Shqipërisë së Jugut me Greqinë dhe aspak nuk e njihnin kombësinë shqiptare, madje edhe i quanin shqiptarët myslimanë, turq. Në të gjithë artikujt e revistës, përveç sulmeve ndaj shovinizmit grek, do t’iu bëhen thirrje edhe shqiptarëve që të mos hiqnin dorë nga të drejtat e tyre kombëtare, pa marrë parasysh sulmeve dhe shkishërimeve, sepse të qenit e tyre ortodoksë nuk i bënte grekë. Ata gjithashtu i urdhëronin këta shqiptarë që të jepnin kontributin e tyre për zhvillimin e gjuhës, arsimin dhe kulturën e popullit të tyre, pasi të punojnë për Greqinë përfundojë i vrarë njëjtë si suljotët e shumë arvanitas të rënë në luftë për ta.⁷

Te **“Drita”** nuk u lanë mangët edhe vendet tjera fqinje si Mali i Zi, Serbia e Bullgaria. Ato akuzoheshin si shtete ekspansioniste ndaj tokave shqiptare. Sipas një artikulli të kësaj reviste, Mali i Zi donte të merrte tokat në Veri, si në Shkodër, Malësi dhe Gjakovë, kurse Serbia pjesën tjetër të vilajetit të Kosovës. **“Drita”** po ashtu, bëri polemika edhe me shtypin serb e malazez që i paraqisnin shqiptarët si njerëz të egër. Ajo edhe pse botohej në Bullgari, do t’i dënonte politikën shoviniste të shtetit bullgar. Ky shtet konsiderohej si një dorë e zgjatur e Rusisë, që gjithashtu kishte pretendime në copëtimin e Shqipërisë. Sipas revistës ishte pikërisht autonomia e krahinës së Maqedonisë që llogaritej si një projekt shovinist bullgar. Dihet gjithashtu, se **“Drita”** do të bëjë polemika me gazetën bullgare *“Veçernja posta”*, e cila në disa artikuj të saj i kishte nënçmuar shqiptarët.⁸

⁷*Historia e Popullit Shqiptar II...*, f. 348; Blendi Fevziu, *vep. cit.*, f. 32; Zihni Haskaj, *vep. cit.*, f. 370-376, 378-384, 387-390, 393-398, 404-410, 412-414, 418-421, 438-442.

⁸Zihni Haskaj, *vep. cit.*, f. 398-400; Ismet Dërmaku, *vep. cit.*, f. 273.

Gjithashtu, edhe *Reformat në Maqedoni* nuk shiheshin me sy të mirë pasi sipas kësaj reviste ato copëtonin tokat shqiptare dhe lejonin depërtimin e Fuqive të Mëdha dhe të vendeve fqinje brenda territoreve shqiptare. Me këtë, ajo pohonte se dy vilajetet, i Kosovës dhe Manastirit, me shumicë shqiptare, mund të përfundonin në duart e një shteti fqinj, me më shumë gjasa, Bullgarisë. **“Drita”** shprehej shumë e sigurt se reformat që parashiheshin do të dështonin dhe se ato nuk do të sillnin gjë tjetër vetëm se ndarje të interesave të vendeve fqinje. Ajo për këto reforma më së shumti akuzonte Rusinë, e cila edhe kishte insistuar më gjatë që ato të ndërmerren. Gjithashtu, sipas revistës, edhe Austro-Hungaria kishte faj, për vetë faktin se e kishte lejuar një gjë të tillë të ndodhte dhe se me anë të *status quo*-së në Ballkan po lejonte dëmtimin e interesave shqiptare.⁹

II.2. Gjendja e shqiptarëve dhe lufta e tyre për pavarësi nga Perandoria Osmane

Kontributin dhe mundin më të madh **“Drita”** do ta japë në përditësimin e luftës kundër sundesve osmanë. Kjo shihet qartë, pasi që në numrin e parë të saj do të botojë artikullin *“E vërteta”* ku tregonte gjendjen e mjerueshme të popullit shqiptar nën sundimin osman dhe propozonte që program i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare të ishte vepra e Sami Frashërit *“Shqipëria çka qenë, ç’është e çdo të bëhet”*. Ajo do të ishte edhe zëri i shqiptarëve të Shqipërisë, ku në faqet e saj do të botoheshin mjaft letra që tregonin gjendjen e popullatës. Në adresë të saj vinin letra nga Janina, Berati, Elbasani, Kosova, Korça, Parga etj., në të cilat tregoheshin se si autoritetet osmane sillleshin ndaj shqiptarëve, duke ua marrë taksat, duke i plaçkitur, vrarë e burgosur.¹⁰

Aty u pasqyrua edhe gjendja e rekrutëve shqiptarë të cilët merreshin dhe dërgoheshin për të luftuar diku në Azi, për të mos u kthyer më kurrë. **“Drita”** do të dalë kundër rekrutimit të shqiptarëve në ushtrinë osmane, që i dërgonin më pas në Lindje. Sipas saj shqiptarët më mirë duhej të iknin, të dilnin në mal, se sa të vriteshin diku në vend të huaj për interesa të shtetit osman. Ajo po ashtu do të jep shembuj mjaft të qartë të kalbëzimit të institucioneve osmane, se si ato kishin arritur deri aty sa të akuzuarit për vrasje që jepnin para i lironin, kurse atdhetarët që kërkonin të drejta për kombin shqiptar i burgosnin dhe internonin.

Te revista po ashtu u fol për vjeljen e taksave, si merreshin, sa ishte shuma dhe ku përfundonin ato. Në shumë raste aty tregoheshin ndodhi të vërteta se si një grua e ve me fëmijë që burri i ishte vrarë në luftë kundër arabëve të Jemenit, tmerrohej nga taksambledhësit osmanë pasi nuk i paguante detyrimet ndaj shtetit. Një shembull tjetër tregonte historinë e një plaku nga Kosova, i cili, pa dy djemtë e tij të shkuar ushtarë dhe me skamje të madhe, nuk mundte t’i paguante taksat ndaj shtetit osman dhe për këtë rrihej vazhdimisht nga autoritetet.¹¹

Revista njashtu vajtonte disa shqiptarë, të cilët kishin qenë në gjumë të thellë dhe se të ndikuar nga fanatizmi fetar po bëheshin robër të Perandorisë Osmane. Sipas revistës, populli ynë e kishte mbajtur të gjallë dhe kishte vdekur për këtë shtet, i cili tani po ua rrjephte lëkurën. Në artikullin e Shahin Kolonjës *“Më nuk gënjehemi”* thuhej se shqiptarët, falë veprimtarisë së shumë atdhetarëve tanimë kishin filluar të mos iu besojnë gënjeshtrove të shtetit osman dhe se do të ishte më e vështirë të manipuloheshin prej tij. Gjithashtu edhe Asdreni e Aleksandër Xhuvani shpreheshin optimistë se në Shqipëri kishte filluar të ketë lëvizje të vërteta, të cilat punonin vetëm për të mirën e kombit shqiptar. Sipas tyre kjo do të shkonte vetëm duke u zmadhuar deri në çlirimin e plotë të vendit. Ndërkaq, Petro Nini Luarasi thoshte se shqiptarët, pasardhës të

⁹Ismet Dërmaku, *vep. cit.*, f. 269, 292, 295, 300; Zihni Haskaj, *vep. cit.*, f. 451-466, 473-476.

¹⁰*Historia e Popullit Shqiptar II...*, f. 345; Ismet Dërmaku, *vep. cit.*, f. 261-262; Zihni Haskaj, *vep. cit.*, f. 131.

¹¹Zihni Haskaj, *vep. cit.*, f. 40-71, 73-82, 191, 195-199; Ismet Dërmaku, *vep. cit.*, f. 136, 268-269.

pellazgëve dhe ilirëve, nipat e Lekës së Madh dhe Skënderbeut, nuk duhej të qëndronin në gjumë dhe të mos kapnin pushkën për çlirimin e atdheut. Para tyre tani qëndronte një detyrë shumë e rëndë.¹²

Në fletët e **“Dritës”** fjalë aspak të mira nuk thuheshin as për Shaqir e Shemsi Pashën, të cilët shtypën kryengritjet e Malësisë së Gjakovës dhe të Prizrenit. Revista këta i trajtonte si njerëz të pashpirt dhe të korruptuar deri në fyt që kishin shkëlur betimet e dhëna se nuk do të torturonin popullatën, nëse s’do të paguante taksa. Në adresë të revistës arriti një letër që tregonte masakrat dhe dëmet që ushtritë osmane kishin bërë në Podrime e në Malësi të Gjakovës, ku si fajtor kryesor e llogarisnin Shemsi Pashën.¹³

Shahin Kolonja do të ishte ndër të parët atdhetar që nga fillimi që do të dilte kundër xhonturqve. Sipas tij në artikullin *“Turqia ç’është? Turqit e rinjë ç’janë?”* edhe ata njëjtë si sulltani nuk do të respektonin të drejtat e popullit shqiptar dhe se me doktrinën e tyre të *Osmanizmit* donin zhbërjen e kombit tonë. Prandaj, ai bënte thirrje se ishte e kotë bindja e disa personaliteteve se do të kishin dobi nga këto lëvizje në shtetin osman. **“Drita”** po ashtu, në mjaft raste do të polemizonte edhe me gazetën xhonturke *“Osmanli”*.¹⁴

Po ashtu, revista e Shahin Kolonjës kishte edhe qëndrim demokratik, prandaj ajo do të dalë kundër parisë shqiptare. Sipas saj ata ishin bashkëpunëtorë dhe njëkohësisht bashkëfajtorë me osmanët për gjendjen e mjerueshme të popullit shqiptar. Njëjtë si autoritetet osmane edhe ata shtypnin, vidhnin e plaçkitnin popullin e thjeshtë dhe shumica e tyre ishin në gjendje të dilnin kundër çdo lëvizje me karakter çlirimtar. Si shembuj më konkretë merrte pashallarët e Këlcyrës, Vlorës, Beratit etj.¹⁵

Për të gjitha vuajtjet dhe dëmet e mësipërme që shqiptarët i hiqnin nga Perandoria Osmane, revista në artikullin *“Ç’duhet të bëjnë shqiptarët për të parë dritë të bardhë”* por edhe në shkrime tjera, mbante qëndrimin që të gjithë shqiptarët gegë e toskë, myslimanë dhe të krishterë të bashkoheshin drejt një qëllimi të vetëm dhe me anë të luftës, të udhëhequr nga një lidhje mbarëkombëtare të arrinin çlirimin dhe krijimin e shtetit kombëtar. Për këtë arsye gazeta do t’iu jepte shumë rëndësi kryengritjeve të viteve 1904-1905, duke ngritur lartë trimërinë e treguar nga shqiptarët dhe duke akuzuar shtetin osman si vrasës dhe shtypës të popullit.¹⁶

Një jehonë të madhe **“Drita”** i dha edhe Komitetit *“Për lirinë e Shqipërisë”* dhe çetave të saj. Aty u botuan mjaft letra e artikuj të kryetarit të këtij komiteti, Bajo Topulli që tregonte të vërtetën për funksionimin e tij. Në faqet e kësaj reviste u botuan edhe letrat e Mihal Gramenos siç ishte ajo me titull *“Ndjenjat e një mëmëdhetari”*, ku ai tregonte arsyen e daljes së tij në mal dhe veprimtarinë e deriatëhershme të çetave të armatosura. Do të ishte edhe Hilë Mosi, i cili me anë të një thirrjeje *“Çonju”* i ftonte të gjithë shqiptarëve që të bashkohen me çetat e Komitetit dhe të arrinin lirinë e vendit të tyre. Aty u botuan edhe letrat e Çerçiz Topullit siç ishte *“Letrë nga malet e Shqipërisë”* ku edhe ai tregonte të gjithë veprimtarinë e çetave deri në atë kohë, e përgëzonte **“Dritën”** për mbështetjen që po iu jepte dhe bënte thirrje për bashkimin e shqiptarëve në një lëvizje të vetme. Gjithashtu, do të ishte vetë revista dhe redaktori i saj që do t’iu jepte jehonë betejave që çetat zhvillonin kundër ushtrisë osmane dhe ato i shihte si fillimi i çlirimit të shqiptarëve. Aty u fol për betejat në Mashkullorë, Berat, Gjirokastër etj.¹⁷

¹²Ismet Dërmaku, *vep. cit.*, f. 263-264, 265-267; Zihni Haskaj, *vep. cit.*, f. 143-146, 152-156.

¹³Zihni Haskaj, *vep. cit.*, f. 135-136, 196-197.

¹⁴Ismet Dërmaku, *vep. cit.*, f. 264-265; Zihni Haskaj, *vep. cit.*, f. 161-163.

¹⁵Zihni Haskaj, *vep. cit.*, f. 163-165.

¹⁶Ismet Dërmaku, *vep. cit.*, f. 266-267, 293; Zihni Haskaj, *vep. cit.*, f. 186-192.

¹⁷Zihni Haskaj, *vep. cit.*, f. 198-204, 207-222; Ismet Dërmaku, *vep. cit.*, f. 266, 299, 309, 311.

Përfundimi

Revista **“Drita”** siç edhe e përmendëm më lartë, ka dhënë kontributin e saj të pashlyeshëm në zhvillimin e shtypit dhe kulturës shqiptare në përgjithësi. Ajo u bë zëri i të gjitha lëvizjeve apo njerëzve që kërkonin çlirim nga Perandoria Osmane, duke mos kursyer asnjë mjet. Së bashku me **“Albanian”** e Konicës, janë dy ndër gazetatat më të famshme të periudhës së Rilindjes Kombëtare, me tirazh më të madh dhe shtrirje më të gjerë.

Në punimin tonë e pamë se përveç dhënies jehonë të luftës për çlirim kombëtar, te kjo revistë nuk mungonin edhe artikujt për gjuhën, kulturën dhe artin shqiptar, duke dhënë një kontribut të veshëm për ngritjen e vetëdijes dhe emancipimit të shqiptarëve.

Me revistën **“Drita”** bashkëpunuan shumë figura të rëndësishme të Rilindjes Kombëtare, si Aleksandër Xhuvani, Asdreni, Fan Noli, Mihal Grameno, Çerçiz Topulli etj., por padyshim se kontributin më të madh në të e dha vetë botuesi i revistës, Shahin Kolonja, një personalitet i gjithanshëm i kohës.

Padyshim, se gjithçka që është botuar në revistë nuk është përmendur në punimin tonë. Prandaj ne inkurajojmë studiuesit e tjerë që t’iu qasen më thellë hulumtimeve rreth veprimtarisë së gazetës **“Drita”**, sidomos në rrafshin e përkrahjes së luftës së shqiptarëve për çlirim kombëtar, ku gjejmë artikujt të pafund të shkruar nga autorë të ndryshëm. Jo më pak e rëndësishme është edhe veprimtaria e shtypit shqiptar të periudhës së Rilindjes Kombëtare në përgjithësi, ku nevojitet një studim i thellë i përmbajtjes së gazetave dhe revistave të kohës dhe kontributit të tyre për çështjen kombëtare shqiptare.

Bibliografia:

- [1]. Dërmaku, Ismet, *Rilindja Kombëtare Shqiptare dhe kolonitë shqiptare të mërgimit në Rumani dhe Bullgari*, Prishtinë: Progres-S. Gjorgjeviq, 1987.
- [2]. Fevziu, Blendi, *Histori e shtypit shqiptar 1848-2005*, Tiranë: Onufri, 2005.
- [3]. Haskaj, Zihni, *Mendimi politik dhe shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare (Përmbledhje artikujsh nga shtypi)*, vëllimi I, Tiranë: Mihal Duri, 1971.
- [4]. *Historia e Popullit Shqiptar II-Rilindja Kombëtare-vitet e 30 të shek. XIX-1912.*, Tiranë: Toena, 2002.
- [5]. Ramadani, Fehari, *Kontributi i Austro-Hungarisë për zhvillimin e arsimit dhe të kulturës shqiptare 1900-1912*, Tetovë: Arbëria Design, 2010.